

Vendim nr. 91 datë 24.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 24.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Xh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **XHAVIT XHELEKU,**
 BASHKIM XHELEKU

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2634 (203), datë 30.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe dërgimi për rishqyrtim po në atë gjykatë.**
Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes, urdhërimi i përsheptimit të gjykimit dhe caktimi i shpërblimit të drejtë për shkak të shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e saj.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Xhavit Xheleku dhe Bashkim Xheleku, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë, kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë të një pasurie, pyje dhe kullota, me sipërfaqe 47495 m², të ndodhur në fshatin Stërmas, Tiranë. E drejta e pronësisë për këtë pasuri i është njohur trashëgimlënësit të kërkuesve, në cilësinë e subjektit të shpronësuar, bazuar në ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Pasuria është regjistruar në hipotekë në emër të të gjithë trashëgimtarëve dhe nëpërmjet kontratës së shitjes së datës 16.09.2003 ka kaluar në emër të kërkuesve.

2. Po kështu, shtetasit H. Sh., D. Sh., Xh. Sh. dhe M. Sh. rezultojnë se janë bashkëpronarë të një pasurie të paluajtshme të ndodhur në Mjull Bathore, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 9500 m², të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”. Këta shtetas, në datat 31.01.2001 dhe 05.12.2001, kanë lidhur kontrata qiraje, përkatësisht me shoqërinë “A.M.C.” sh.a. për sipërfaqen prej 300 m² truall kundrejt çmimit 1,800 dollarë (USD) në vit dhe shoqërinë “V. A.” sh.a. për sipërfaqen prej 450 m² truall kundrejt çmimit 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë në vit.

3. Kërkuesit duke pretenduar pronësinë mbi truallin objekt konflikti i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt fillestar pagimin e qirasë për përdorimin e sendit dhe, në vijim, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të marrjes së tokës në pronësi, në emër të të paditurve. Gjykata, fillimisht, e ka kthyer padinë pa veprim me vendimin nr. 8214, datë 20.11.2007.

4. Mbi bazën e ankimit të paditësve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 94, datë 22.04.2008, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit.

5. Pas rigjykitimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2922, datë 20.03.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e shoqërive që të paguajnë në favor të kërkuesve detyrimet në shumat 1,260,564 lekë dhe 1,890,846 lekë dhe shumat 21,900 lekë në muaj dhe 32,850 lekë në muaj për përdorimin e sendit, nga dita e relatimit të aktit deri në

një marrëdhënie të dytë kontraktore të palëve, si dhe rrëzimin për pjesën tjetër të padisë në lidhje me të paditurit e tjerë H. Sh., D. Sh., Xh. Sh. dhe M. Sh., si padi pa objekt. Gjykata ka arsyetuar se të paditurit në gjykim nuk kanë pasur tagra nga pronari legjitim në lidhje me përdorimin e sendit dhe kontratat e qirasë janë nënshkruar nga një person, i cili nuk ka tagra pronësie mbi këtë truall. Pasqyrimi grafik i pronës së paditësit pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme është i gabuar, pasi ky pasqyrim nuk gjen mbështetje në hartën treguese të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili është dokumenti bazë për restaurimin e së drejtës dhe në bazë të të cilit duhej të kryhej regjistrimi i pasurisë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2778, datë 24.06.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2922, datë 20.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me detyrimin e të paditurve, dy shoqërive, për pagimin e detyrimit për përdorim sendi paditësve dhe ndryshimin e tij lidhur me rrëzimin e padisë për të paditurit: H. Sh., D. Sh., Xh. Sh. e M. Sh., duke e deklaruar të pavlefshëm aktin e marrjes së tokës në pronësi, për sipërfaqen që ka mbivendosje me pronën e paditësve, konkretisht, për sipërfaqet 95 m² dhe 300 m². Gjykata ka arsyetuar se nga akti i ekspertimit ka rezultuar se ka mbivendosje të pronës dhe legjitimiteti i paditësve për të kërkuar pavlefshmërinë e aktit të marrjes së tokës në pronësi është i ligjshëm, vetëm për pjesën që ka mbivendosje. Për atë pjesë që nuk ka mbivendosje gjykata nuk mund të shprehet, për sa kohë ajo pjesë nuk ka krijuar konflikt me paditësit.

7. Mbi bazën e rekurseve të ushtruara nga shtetasit H. Sh., D. Sh., Xh. Sh. dhe M. Sh., në datën 30.06.2014, si dhe shoqëria “A.M.C.” sh.a., në datën 12.02.2015, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2634 (203), datë 30.05.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ajo ka argumentuar se në rekurs ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Sipas saj, Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se akti i dhënies së tokës në pronësi, është marrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji dhe, në rastin konkret, komisioni i tokës ka shpërndarë një sipërfaqe, e cila nuk ka qenë tokë bujqësore e që nuk ishte vënë në dispozicion të tij. Gjykata e Lartë ka çmuar se për të arritur në një përfundim të tillë është e nevojshme kryerja e një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm dhe se roli i gjykatës në këtë proces është të garantojë kontradiktoritetin dhe barrën e provës përkatëse të palëve në gjykim për të vërtetuar paraprakisht pretendimin e prapësimin përkatës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të marrjes së tokës në pronësi në emër të të paditurve H. Sh., D. Sh., Xh. Sh. dhe

M. Sh. Sqarimi dhe vërtetimi i këtyre rrethanave të faktit, të pretenduara dhe të prapësuar nga palët në gjykim, por edhe kryerja e veprimeve të tjerave, që eventualisht mund të dalin gjatë rigjyimit, do ta lejojnë gjykatën e apelit që, në përputhje me kërkesat e ligjit procedural, të mund të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes në pranimin e plotë/pjesshëm ose rrëzimin e padisë.

8. Në datën 06.03.2023 kërkesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2634 (203), datë 30.05.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, si dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes, urdhërimin e përshpejtimit të gjyimit dhe caktimin e shpërblimit të drejtë për këtë qëllim.

II

Pretendimet e kërkesve

9. **Kërkesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se Gjykata e Lartë u ka cenuar të drejtën e pronës të lidhur me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi pjesa urdhëruese e vendimit të arsyetuar dhe e dorëzuar në datën 03.11.2022 është e ndryshme nga pjesa urdhëruese e shpallur publikisht në faqen elektronike të asaj gjykate në datën 30.05.2022. Sipas kësaj të fundit, pasqyrohet se gjykata ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur. Kjo lloj situatë bie në kundërshtim me parimin e karakterit publik të procesit gjyqësor të përcaktuar në nenin 26 të KPC-së, duke sjellë, për pasojë, cenimin jo vetëm të parimit të publicitetit dhe transparencës, por edhe atë të besimit të publikut te drejtësia e gjyimit. Në kushtet kur shpallja e ditës së shqyrtimit të çështjes në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë konsiderohet njoftim në kuptim të ligjit, për efekt të zhvillimit të gjyimit, e njëjta gjë vlen edhe për njoftimin e pjesës urdhëruese.

9.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë mungojnë udhëzimet, konkluzionet në të cilat ajo ka arritur lidhur me faktin juridik dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe detyrat konkrete të detyrueshme për gjykatën e apelit. Ajo gjykatë nuk i ka dhënë përgjigje argumenteve, por ka përmendur vetëm

konkluzionet e gjykatave më të ulëta pa i arsyetuar nëse i pranon ose i kundërshton ato, duke e bërë vendimin kontradiktor dhe të paqartë.

9.3. *Gjykimit të drejtë*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me kompetencën e saj të përcaktuar në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës dhe nenet 472, 473/a, 474, 475, 476 dhe 480 të KPC-së. Ajo, pavarësisht se ka renditur në mënyrë të plotë pretendimet e palëve ndërgjyqëse, nuk ka përmendur shkaqet që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, shkeljet e rënda procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta, me praktikat gjyqësore të ndryshme të saj dhe vendimmarrje të kolegjit për të vënë në diskutim çështje të ligjit.

9.4. *Së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi padia është paraqitur në datën 20.09.2006, ndërsa çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 17.09.2014 dhe me vendimin e datës 30.05.2022 për kthimin për rigjykimin e saj në gjykatën e apelit, afati i gjykimit llogaritet mbi 16 vjet. Lidhur me këtë fakt, ata i kanë kërkuar gjykatës së apelit përshpejtimin e gjykimit, por ende nuk kanë një vendimmarrje lidhur me këtë kërkesë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse (paditës) në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

14. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës, duke i parashtruar asaj dy kërtime në objekt. Kërkimi i parë lidhet me shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2022-2634 (203), datë 30.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2778, datë 24.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ndërsa kërkimi i dytë lidhet me konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes, urdhërimin e përsheptimit të gjykimit dhe caktimin e shpërblimit të drejtë për shkak të shkeljes së kësaj të drejte.

16. Për sa i takon kërimit të parë që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji evidenton se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në kushtet kur procedurat gjyqësore për shqyrtimin në themel të çështjes nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkuetit kanë ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e tyre përpara atyre gjykatave, përfshirë edhe pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit, për shkak të mospërputhjes së dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

17. Lidhur me kërkimin e dytë për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit, Kolegji sjell në vëmendje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që gjatë shqyrtimit të rekursit kërkuetit të kenë përdorur këto mjete ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe për të kërkuar shpërblim dëmi, për rrjedhojë ata nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Faktin e përmendur në ankimin kushtetues individual se ende nuk kanë marrë përgjigje për kërkesën për përshpejtim të paraqitur në gjykatën e apelit, ata nuk e kanë shoqëruar me argumente bindëse se ky mjet nuk rezulton të jetë efektiv, në kushtet kur vendimi i arsyetuar është bërë i disponueshëm në datën 03.11.2022, referuar shkresës nr. 5934/1 prot., datë 09.11.2022 të Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, ata kanë ende mjete juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohen gjykimit kushtetues për pretendimin e cenimit të kësaj të drejte.

19. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji vlerëson se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 27.04.2023